



REPUBLIKA E SHqipërisë
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601773/9

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandohet mbështetja e nevojshme financiare për rindërtimin e Ujësjetës në Fshatit Gjorëm, Bashkia Kurbin, për të bërë të mundur furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve.*

Drejtuar : **Ministrisë të Financave**

TIRANË

Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë

TIRANË

Për dijëni : **Kryetarit të Bashkisë**

KURBIN

Të nderuar zotërinj!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka në proces shqyrtimi çështjen e mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve të Fshatit Gjorëm, Bashkia Kurbin, prezantuar, prej Kryesisë së këtij Fshati.

Me rastin e prezantimit të kësaj çështjeje prej banorëve të këtij fshati, pranë Institucionit që unë përfaqësoj, është bërë e mundur marrja e informacionit prej Insitutit të Shëndetit Publik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Me shkresën nr.746/1 Prot, datë 09.06.2017, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, Instituti i Shëndetit Publik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, bën të mundur vënien në dispozicion të shkresës nr.647 Prot, datë 09.09.2016, që Drejtoria e Shëndetit Publik, Kurbin, në të cilën prezantohet gjendja aspak normale e Ujësjetës të Fshatit, Gjorëm, Bashkia, Kurbin. Me këtë Shkresë, informohet se, citojmë;

“Drejtoria e Shëndetit Publik, Kurbin, së bashku me Ndërmarrjen e Ujësjetës Sh.a. Kurbin, bëri vlerësimin higjenik të Ujësjetës Rajonal të Fshatit, Gjorëm.

Ky Ujësjiellës, i cili është në funksion, nuk plotëson asnjë parameter higjienik pasi pjesa dërrmuese e linjës shpërndarëse është me tuba asbesti, për këtë arsye ky ujë nuk duhet të lejohet për konsum publik deri në momentin që ky rrjet shpërndarëse të rindërtohet me material të parrezikshme për shëndetin publik”.

Kjo gjë konfirmohet edhe zyrtarisht nga Ndërmarrja e Ujësjiellësit Kurbin. Konkretisht, Ujësjiellësi Kurbin Sh.a., në shkresën nr.342 Prot, datë 03.11.2016, drejtuar Drejtorisë së Shëndetit Publik, Kurbin, konfirmon se:

“Gjendja e burimit:

- *Furnizimi me ujë për Fshatin Gjorm, është me rrjedhje të lire, uji del nga një shkëmb i cili quhet “Gurra e Ploçkës”.*

Gjendja e tubacioneve dhe pusetave:

- *Godina e rezervuarit dhe Stacioni i Pompës, Fshati Gjormë, është një investim i lënë në mes në Vitin 1996 dhe është shkatërruar gjatë Vitit 1997.*
- *Rezervuari është me kapacitet 80m³.*
- *Magjistrali është linjë “Fi” 150 çelik. Kjo linjë është tej mase e amortizuar dhe jo funksionale.*
- *Linjat shpërndarëse nuk ekzistojnë në pjesën më të madhe të rrjetit dhe pjesa eksistuese e tyre është me material asbest (eternit).*
- *Fshati Gjormë furnizohet me ujë të pijshëm me linjë private.*

Deri më tani Ujësjiellësi, Kurbin Sh.a., nuk e ka në varësinë e tij këtë ujësjiellës dhe as pjesë të inventarit të tij”.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standarteve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjin nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, gjen me vend të ndërhyjë pranë jush për zgjidhjen e çështjes së prezantuar, për të garantuar të drejtën e banorëve për t’u furnizuar me ujë.

Na rezulton se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk zotëron fondet apo mjetet e mjaftueshme për arritjen e standartit dhe normave kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të Fshatit, Gjorëm, Bashkia, Kurbin, dhe për këtë arsye kërkojmë ndërhyrjen tuaj të menjëhershme.

Referuar parashikimeve të nenit 22/3 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia, Kurbin, është përgjegjëse në teritorin e juridiksionit të vet, për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, dhe se në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 30/6 të ligjit në fjalë, Qeverisja qendrore garanton njësitë të vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Praktika për zgjidhjen e çështjeve të tilla, tregon se, në pamundësi të mbështetjes së nevojshme financiare nga Buxheti i Shtetit, Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, ka kryer lidhjen e marrveshjeve për financimin e projekteve mbi bazë të të cilave është zgjidhur problemi i furnizimit me ujë të pijshëm i komuniteteve të banorëve në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Rasti i prezantuar mund dhe duhet të marrë vemendjen që meriton me qëllim zgjidhjen e çështjes së furnizimit me ujë të pishëm të komunitetit të banorëve të Fshatit, Gjorm, Bashkia, Kurbin.

Mbi bazë të këtij vlerësimi, si përfaqësues i Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me sanksionimin e kryer në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe parashikimin e kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

“Marrjen e masve me qëllim gjetjen e burimeve të nevojshme financiare për rindërtimin e Ujësjellsit në Fshatin Gjørëm, Bashkia, Kurbin.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet Rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të kryer në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të shkresës nr.746/1 Prot, datë 09.06.2017, të Bashkisë, Kurbin, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.647 Prot, datë 09.06.2016, të Drejtoria e Shëndetit Publik, Kurbin, drejtuar Insitutit të Shëndetit Publik.

Kopje të shkresës nr.342 Prot, datë 03.11.2016, të Ujësjellsit Kurbin Sh.a., drejtuar Drejtorisë së Shëndetit Publik, Kurbin.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

Në mungesë dhe me porosi

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka